

## Mënyra se si t'i trajtojmë shpenzimet për shëndetin mendor. Financa dhe WSRS [SHMMV]

Orientimet e mëposhtme janë për t'i ndihmuar udhëheqësit e Priftërisë që të ofrojnë ndihmë financiare për shërbimet e këshillimit për anëtarët e lagjes së tyre. *Nëse keni pyetje të tjera, ju lutemi, drejtojuni autoritetit tuaj kryesues ose ekipit të përkrahjes së njësisë vendore.*

### **Kur duhet të sigurojë një Peshkop fonde për vlerësimet para misionit?**

Me kërkesë të një peshkopi ose presidenti kunji, vlerësimet falas para misionit janë në dispozicion për misionarët/et e ardhshëm/me që përjetojnë probleme shoqërore dhe emocionale. Vlerësimi para misionit kryhet nga një këshillues i licencuar. Në Zonën e Europës ky shërbim paguhet duke përdorur fondet e Ofertës së Agjërimit. Shih <https://providentliving.churchofjesuschrist.org/lds-family-services/missionary-services?lang=eng>

### **A janë misionarët/et që kthehen herët në shtëpi të përshtatshëm/me për shërbimet e këshillimit?**

Misionarët/et që kthehen herët në shtëpi dhe misionarët/et që transferohen në një mision me shërbim për shkak të sfidave emocionale, mund të marrin deri në gjashtë sesione këshillimi falas. Në Zonën e Europës këto shpenzime mbulohen duke përdorur fondet e ofertës së agjërimit. Shih <https://providentliving.churchofjesuschrist.org/lds-family-services/missionary-services?lang=eng>

### **A mund të përdoren fondet e Kishës për të paguar shërbimet e këshillimit?**

Peshkopët mund t'i drejtojnë anëtarët që kanë nevojë për këshillim te një listë e këshilluesve profesionistë me famë të mirë. Nëse anëtarët nuk janë në gjendje të paguajnë vetë ose nëpërmjet siguracionit për këshillim profesional, peshkopët kanë mundësinë t'i ndihmojnë me pagesat duke përdorur fondet e ofertës së agjërimit. Përpara se të ofrojë ndihmë nga Kisha, peshkopi (ose një udhëheqës apo një anëtar tjetër që ai cakton) shqyrton me anëtarin/en(ët) se çfarë burimesh ai/ajo/ata po përdor/in për të plotësuar nevojat e tij/saj ose të tyre. Ky person mund të sugjerojë burime të tjera që të merren parasysh nga ana e anëtarit/es(ve), përfshirë burimet e ofruara nga qeveria ose burime të komunitetit. Shih General Handbook of Instruction [Manuali i Përgjithshëm i Udhëzimeve], seksionet 22.3.4, 31.2.6 dhe 22.4.1.

### **A ka limite financiare për shërbimet e këshillimit?**

Kur peshkopët i përdorin ofertat e agjërimit për të ndihmuar për pagimin e kujdesit mjekësor, dentar apo shëndetit mendor, shpenzimet nuk duhet t'i kalojnë limitet e miratuara. Aktualisht, Peshkopët mund të miratojnë deri në 5 000 USD (dollarë amerikanë) për një rast në zonën e Europës. Shih General Handbook of Instruction [Manuali i Përgjithshëm i Udhëzimeve], seksionet 22.5.2.1

Peshkopët duhet të ushtrojnë gjykim të mirë dhe të kërkojnë drejtim shpirtëror kur marrin në shqyrtim shumën dhe kohëzgjatjen e ndihmës së dhënë. Ata duhet të jenë të dhembshur

dhe bujarë ndërkohë që nuk krijojnë varësi. Shih General Handbook of Instruction [Manuali i Përgjithshëm i Udhëzimeve], seksionet 22.5.2.1 dhe 22.4.2

**Kur një Peshkop bie dakord që të paguajë një pjesë të kostove për shërbimet e këshillimit, si bëhen pagesat?**

Anëtari e paguan faturën të plotë, pastaj i jep një provë të pagesës peshkopit që të marrë rimbursim të pjesshëm nëpërmjet Lagjes. Nëpunësi për financat ka nevojë të deklarojë të fusha e përshkrimit se kjo është një pagesë e pjesshme.

**A mund të paguajë një Peshkop për shërbimet e këshillimit për anëtarët jashtë kufijve të lagjes së tij?**

Peshkopët kufizohen për t'iu ofruar ndihmë financiare vetëm anëtarëve të lagjeve të tyre. Nëse një individ e ndryshon lagjen, ai ose ajo ka nevojë të takohet me Peshkopin e tij ose të saj të ri për të marrë ndihmë për shërbimet e këshillimit.

**A mund të paguajë një Peshkop për shërbimet e këshillimit jashtë vendit të vet?**

Kur një Peshkop ka shërbime këshillimi të kufizuara ose nuk ka në dispozicion shërbime të tilla, anëtari mund të zgjedhë që të përdorë një shërbim këshillimi jashtë vendit të vet. Nëse kjo ndodh, anëtarit i kërkohet të paguajë për shërbimet e më pas Lagja do të rimbursojë kostot mjekësore për shërbimet e këshillimit.

**Kur një anëtar nuk mund ta paguajë faturën e shërbimeve të këshillimit, si paguhet fatura?**

Anëtari ia sjell faturën Peshkopit, i cili ia autorizon pagesën e faturës direkt ofruesit të shërbimeve të këshillimit. Shih Qendra e Ndhmës për LCR-në (kurdoherë që është e mundur, pagesat duhet t'i bëhen ofruesit të të mirave materiale dhe shërbimeve dhe jo personit që po ndihmohet ose individëve të tjerë).

**Në cilën kategori të shpenzimeve duhet të caktohen shërbimet e këshillimit?**

Peshkopët duhet të përdorin kategorinë “mjekësore” për shërbimet e këshillimit.

**Kujt i duhet lëshuar fatura?**

Faturat mjekësore duhet t'i lëshohen gjithmonë individit. Peshkopi ose subjektet e Kishës nuk duhet të përfshihen në faturë.